LIGJ
Nr.10 134, datë 11.5.2009

PËR KRIJIMIN E QENDRËS SË PANAIREVE DHE TË EKSPOZITAVE TREGTARE

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj synon ngritjen e Qendrës së Panaireve dhe të Ekspozitave Tregtare, si dhe përcakton rregullat e funksionimit e të veprimtarisë së kësaj qendre.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të nxisë zhvillimin e panaireve dhe të ekspozitave tregtare, për të rritur investimet dhe shkëmbimin tregtar, si dhe për të përhapur njohuri për risitë teknologjike e shkencore të sektorëve të ndryshëm prodhues dhe të shërbimit në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Qendra e Panaireve dhe e Ekspozitave Tregtare" (QPET) është një person juridik, shoqëri tregtare, e krijuar me pjesëmarrjen e shtetit dhe të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, e ngritur në përputhje me dispozitat e këtij ligji.
2. "Dhoma" është Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë, e ngritur në përputhje me ligjin nr.9640, datë 9.11.2006 "Për dhomat e tregtisë dhe industrisë", të ndryshuar.
3. "Panair i përgjithshëm" është veprimtaria promovuese, e hapur për publikun, ku ekspozohen shërbimet, të gjitha llojet e mallrave ushqimore, industriale e të konsumit, teknologjitë, si edhe libri e produktet e përafërta me të, të cilat mund ose jo të jenë objekt i shitjeve të drejtpërdrejta, sipas parashikimeve të bëra në kalendar.
4. "Panair kombëtar" është veprimtaria, në të cilën marrin pjesë ekspozues, që e shtrijnë këtë veprimtari në të gjithë territorin e vendit ose dhe jashtë tij.
5. "Panair ndërkombëtar" është veprimtaria, ku marrin pjesë ekspozues e ku të paktën 10 për qind e tyre janë të huaj.
6. "Panair i specializuar" është veprimtaria e një ose më shumë sektorëve të ngjashëm ndërmjet tyre, ku marrin pjesë si ekspozues vetëm prodhues dhe operatorë tregtarë të specializuar, vendas dhe/ose të huaj.
7. "Ekspozitë tregtare" është veprimtaria promovuese, e hapur për publikun, që ka për qëllim të ilustrojë përparimin e arritur në një ose më tepër degë të ekonomisë dhe ku janë të ndaluara shitjet e drejtpërdrejta.
8. "Ministri" është ministri që mbulon tregtinë.

9. “MBUMK” është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit.

10. “KRRTRSH” është Këshilli i Rregullimit të Territorit të Republikës së Shqipërisë, i ngritur në përputhje me ligjin nr.8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, të ndryshuar.

KREU II
QENDRA E PANAIREVE DHE E EKSPOZITAVE TREGTARE

Neni 4
Themelimi

1. Për organizimin e promovimin e veprimtarive të panaireve dhe të ekspozitave tregtare krijohet Qendra e Panaireve dhe e Ekspozitave Tregtare, me pjesëmarrjen e shtetit dhe të Dhomës së Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë.

2. Shteti, i përfaqësuar nga ministri përgjegjës për tregtinë dhe dhoma krijojnë një shoqëri të përbashkët, e cila do të marrë përsipër ngritjen dhe funksionimin e QPET-së, me seli në qytetin e Fushë-Krujës.

3. QPET-ja ngrihet brenda sipërfaqes së tokës bujqësore, në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit (QTTB, Fushë-Krujë), që përbëhet nga ngastrat me numër kadastral a-25/2 (nr. pasurie 334) dhe sipërfaqe 6 (gjashtë) ha, a-29/15 (nr. pasurie 329) dhe sipërfaqe 6,39 (gjashtë presje tridhjetë e nëntë) ha dhe a-40 (nr. pasurie 335), me sipërfaqe 5,3 (pesë presje tre) ha, sipas hartës së paraqitur në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Madhësia e sipërfaqes kalon në përgjegjësi administrimi nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për QPET-në dhe përcaktohet sipas lejes së ndërtimit, që miraton KRRTRSH-ja.

Neni 5
Pjesëmarrja e shtetit

1. Pjesëmarrja e shtetit në QPET realizohet me anë të kontributit në natyrë të sipërfaqes së tokës, sipas përcaktimeve në aneksin 1, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Kontributi i shtetit vlerësohet në raport me vlerën e përgjithshme të investimit, që duhet për ngritjen dhe funksionimin e QPET-së, e cila mbulohet nga dhoma, në përputhje me ligjin nr.9901, datë 14.4.2008 “Për shoqëritë tregtare”.

3. Të drejtat, që lidhen me kuotën e aksioneve, që i përkasin shtetit, në shoqërinë që do të administrojë QPET-në, rregullohen në statutin e shoqërisë, ku, në çdo rast, shteti do të përfaqësohet në organet mbikëqyrëse dhe/ose drejtuese, pavarësisht nga kuota që zotëron.

Neni 6
Statuti i QPET-së

Veprimtaria, funksionimi dhe organizimi i QPET-së përcaktohen në statut, i cili përmban:

a) adresën e selisë së QPET-së;

b) fushën e veprimtarisë;

c) mënyrën e organizimit, funksionet dhe organet drejtuese;

ç) përfaqësimin e QPET-së me të tretët.

Neni 7
Administrimi

1. Forma dhe mënyra e administrimit të QPET-së do të përcaktohen në aktin e themelimit

dhe në statutin e shoqërisë, të parashikuara në nenin 4 të këtij ligji.

2. Statusi i QPET-së përmban të dhënat e përcaktuara në nenet 32 e 36 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, të ndryshuar.

Neni 8
Veprimtaria e QPET-së

1. QPET-ja organizon panaire të përgjithshme, panaire kombëtare, ndërkombëtare dhe të specializuara, si dhe ekspozita tregtare.

2. QPET-ja nuk gëzon asnjë të drejtë ekskluzive për organizimin e veprimtarive të panaireve dhe të ekspozitave tregtare në Republikën e Shqipërisë, si dhe u nënshtrohet të njëjtave rregulla, për lejet dhe kalendarin e panaireve, sipas akteve ligjore e nënligjore në fuqi.

KREU III
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT


Neni 9

Ngarkohet Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6185, datë 25.5.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi


PLANIMETRIA E TOKAVE TE INSTITUTIT
TE KERKIMEVE FORAGJERE F. KRUJE
SHK 1:5000
325
350
300
LUMI GJOLES
7.65 Ha
5.30 Ha
4.37 Ha
5.80 Ha